

## Informacion lidhur me statusin e hidrocentraleve të vogla në malet e Sharrit

### Janar 2021

Procesi për marrjen e koncesionit për funksionimin e hidrocentraleve të vogla ka disa hapa:

1. Miratim nga Ministria e Ekonomisë (Vendim i Qeverisë).
2. Miratim nga MMPH bazuar në vlerësimin e ndikimit në mjedis.
3. Koncesionarët marrin kontratë për ndërtimin e hidrocentraleve dhe marrin subvencione nga qeveria.

Projektet e hidrocentraleve të vogla mund të ndahen në 4 kategori (në varësi të ecurisë së projekteve):

1. Hidrocentralet e vogla për të cilat ka një vendim të qeverisë së RMV-së dhe **janë kritike**.
2. Hidrocentralet e vogla për të cilat Marrëveshja e Koncesionit është lëshuar dhe **janë kritike**.
3. Hidrocentralet e vogla që funksionojnë: këto janë pranuar si infrastrukturë ekzistuese në PK.
4. Hidrocentralet e vogla të planifikuara (të propozuara): këto nuk do të pranohen në PK.

Në këtë fazë, zonimi i ri i propozuar i PK të malit Sharr do t'i ofrojë mbështetje këshilluese Ministrit të Mjedisit sesi do të veprohet me hidrocentralet e vogla. Të gjitha projektet në zonën e qëndrueshme kanë të drejtë ligjore të vazhdojnë ndërtimin derisa ministri nuk shpalli moratorium për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla në malin Sharr.

Ky dokument nuk zëvendëson dokumentin mbi vlerësim e ndikimit në mjedis.

Këshilla e dhënë më poshtë ka marrë parasysh: vlerat natyrore, mendimin e mëparshëm të ekspertëve, konsultimin me komunitat dhe banorët lokal, reagimet e sektorit joqeveritar (letër që i është dërguar publikisht Kryeministrit), konsultim me AD ESM dhe znj. Melita Goshevska nga Sektori i Ujërave në kuadër të MMPH.

**Rekomandimi i ekspertit është dhënë në përputhje me kriteret e IUCN-së për kategorinë II PK. Nga të katër kategoritë, këshilla e ekspertit është të vazhdohet me hidrocentralet e vogla të vendosura vetëm në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm për të cilën veçmë kanë kontratat të koncesionit. Të gjithë koncesionarët e tjerë me projekte të dhëna për ndërtim në zonat aktive ose në zonat rreptësisht të mbrojtura, duhet të ndalohen menjëherë nga çdo ndërtim i mëtejshëm, të tërhiqen dhe të rimbursohen për humbjet e shkaktuara financiare.**

**Deklaratë për publikun:** Nëse ligji për shpalljen dhe zonimin e ri të propozuar mbështetet nga publiku, iniciativa e Parkut Kombëtar të malit Sharr do të ndalojë: 21 hidrocentrale të vogla (6 të miratuara nga qeveria + 15 të planifikuara) dhe do të parandalojnë ndërtimin e 5 hidrocentraleve (3 në zonën e Lubotenit dhe 2 në brendësi të malit Sharr, në Luginën e Leshnicës) për të cilat ka tashmë kontrata. Gjithsej, 26 hidrocentrale të vogla do të ndalen dhe vetëm 4 të vendosura në zonën e qëndrueshme do të kenë të drejtën ligjore për të vazhduar plotësimin e kontratave të tyre.

## Hidrocentralet e vogla për të cilat ka një vendim nga qeveria e RMV-së

Ky grup përmban hidrocentrale të vogla për të cilët Qeveria ka dhënë vendim pozitiv. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk ka nënshkruar kontratën e koncesionarit dhe hapi i radhës është marrja e një opinioni pozitiv nga sektori për mjedisin duke ndjekur procedurën e vlerësimit të ndikimit.


Duke qenë se të gjithë janë në zonë aktive dhe në zonë rreptësisht të mbrojtur, ky mendim nuk mund të jetë pozitiv, që do të thotë se do të ndalohen automatikisht.

Pasi ligji për shpalljen të kalojë do të jetë bazë në të cilin ministri mund t'i shpjegojë Qeverisë se ato hidrocentrale duhet të ndërpriten.

Ky grup i hidrocentraleve nuk do të ketë implikime të larta financiare sepse nuk ka pasur asnjë koncesion/kontratë. Ndoshta disa kosto do të duhet të i'u rimbursohen aplikantëve për të mbuluar shpenzimet e tyre për përgatitjen e dokumentacionit.

Hidrocentrali nr. 1005 Lisecka (Reçica 1 dhe Reçica 2) ka kontratë dhe tashmë kanë filluar ndërtimin, por kjo është jashtë territorit të propozuar të Parkut Kombëtar.

**Mendimi i ekspertit: Asnjë nga hidrocentralet e vogla me status "Vendim nga Qeveria" nuk këshillohet të vazhdojnë me ndërtim.**



**Tabela: Hidrocentralet e vogla për të cilat ka Vendim nga Qeveria e RMV-së**

Nr.	ID	Emri	Përshkrimi	Zona e mbrojtur e mëparshme	Komenti	Zonimi mbrojtës i ri
1.	441	100 Leshoçka	100 Marrja e lumit Leshoçka	Zona e menaxhimit aktiv	Nuk do të vendoset asnjë zonë tampon, propozohet të mos jepet Marrëveshje për koncesion	Zona e mbrojtjes së rreptë
			100 Ndërtimi i makinerisë në lumin Leshoçka	Zona e menaxhimit aktiv		Zona e mbrojtjes së rreptë
2.	442	101 Leshoçka	101 Marrja e lumit Leshoçka	Zona e menaxhimit aktiv	Nuk do të vendoset asnjë zonë tampon, propozohet të mos jepet Marrëveshje për koncesion	Zona e mbrojtjes së rreptë
			101 Ndërtimi i makinerisë në lumin Leshoçka	Zona e menaxhimit aktiv		Zona e menaxhimit aktiv
3.	662	Bogovinska	Ndërtim në Bogovinska	Zona e menaxhimit aktiv	Nuk do të vendoset asnjë zonë tampon, propozohet të mos jepet Marrëveshje për koncesion	Zona e menaxhimit aktiv
			Ndërtimi i makinerisë në lumin Bogovinska	Zona e menaxhimit aktiv		Zona e menaxhimit aktiv
4.	651	Jelovjanska	Ndërtimi i makinerisë në lumin Jelovjanska	Zona e menaxhimit aktiv	Nuk do të vendoset asnjë zonë tampon, propozohet të mos jepet Marrëveshje për koncesion.	Zona e menaxhimit aktiv
			Jelovjanska	Zona e menaxhimit aktiv		Zona e menaxhimit aktiv
5.	665	Mazdraça	Ndërtim në Mazdraça	Zona e mbrojtjes së rreptë	Nuk do të vendoset asnjë zonë tampon, propozohet të mos jepet Marrëveshje për koncesion	Zona e mbrojtjes së rreptë
			Ndërtimi i makinerisë në lumin Mazdraça	Zona e mbrojtjes së rreptë		Zona e mbrojtjes së rreptë
6.		1005 Lisecka	Reçica 1 Reçica 2	Jashtë PK	Në ndërtim	Jashtë PK


## Hidrocentralet për të cilën është lëshuar Marrëveshja për koncesion

Ky është grupi kritik i hidrocentraleve të vogla ku 9 projekteve i'u është dhënë leje nga qeveria, miratim nga MMPH, dhe ata kanë kontrata për koncesion. Nga 9 projektet një marrëveshje është ndërprerë dhe një është bllokuar nga banorët lokal. Kjo është mar parasysh nga ekspertët e IUCN-së.

Bazuar në zonimin në kuadër të Ligjit për shpallje, Qeveria mund të vendos të anuloj kontratën e koncesionerëve.

**Bazuar në zonimin e propozuar, hidrocentralet e mëposhtme me kontratë për koncesion, të vendosura në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm, mund të vazhdojnë me procesimin e kontratave të tyre: 1007 Lumi Veicka, 80 Karanikolicka, 85 Shkumbini, 91 Shelicë. Hidrocentralet e mëposhtme me kontratë për koncesion, të vendosura në zonën më të rreptë të menaxhimit aktiv, këshillohen që të mos vazhdojnë ndërtimin:**

- 107 hidrocentrali Belovishka nuk do të vazhdojë pasi që banorët lokalë e bllokojnë procesin për shumë vite me rradhë;
- 66 Vratnica gjendet në një zonë shumë të rëndësishme të mbrojtjes së rreptë dhe koncesioneri duhet të paguhet;
- 67 Ljubotenska gjendet në një zonë shumë të rëndësishme të mbrojtjes së rreptë dhe koncesioneri duhet të paguhet;
- 82 Shkumbini gjendet në një zonë shumë të rëndësishme të mbrojtjes së rreptë dhe koncesioneri është gati të bëjë marrëveshje për tërheqje;
- 84 Pena gjendet në një zonë shumë të rëndësishme të mbrojtjes së rreptë dhe koncesioneri duhet të paguhet. Ky është lokacion për të cilin tashmë ka filluar ndërtimi. Duke marrë parasysh presionin e publikut këshillohet që të ndërpritet menjëherë ndërtimi dhe të negociohet me investitorin për rehabilitimin e vendndodhjes.






Foto: Pasqyrë e përgjithshme e hidrocentraleve në zonën e Lubotenit, me kontratë për koncesion që nuk duhet të vazhdojnë ndërtimin




Foto: Pasqyrë e përgjithshme e hidrocentraleve SHPP në zonën e Leshnicë

**Tabela: Hidrocentralet për të cilët është lëshuar marrëveshja për koncesion**

Nr.	I D	Emri	Përshkrimi	Zona e mbrojtur e mëparshme	Koment	Zonimi mbrojtës i ri
1.	219	1007 lumi Veicka	1007 Ndërtimi në Veicka	Zona për shfrytëzim të qëndrueshëm	Procedura për marrjen e lejes së ndërtimit ka vazhduar	Zona për shfrytëzim të qëndrueshëm
			Ndërtimi i makinerisë në Veicka	Zona për shfrytëzim të qëndrueshëm		Zona për shfrytëzim të qëndrueshëm
2.	387	107 Belovishka	107 Ndërtimi në Belovishka	Zona e menaxhimit aktiv	Nuk do të vendoset asnjë rrip mbrojtjes, propozohet anulimi i marrëveshjes për koncesion.  Të hiqet iniciativa nga banorët lokal dhe OJQ-të. Koncesioni nga Ministria e ekonomisë. Banoret lokal e bllokojnë procesin. Ministri i financave ka kërkuar vlerësim për rimbursim.	Zona e menaxhimit aktiv
			Ndërtimi i makinerisë në Belovishka	Zona e menaxhimit aktiv		Zona e menaxhimit aktiv
3.	485	66 Vratnicka (menaxhohet si lumi Lubotenska sipër Vratnicës)	66 Ndërtiminë Vratnicka	Zona për shfrytëzim të qëndrueshëm	Nuk do të vendoset asnjë rrip i mbrojtjes, propozohet anulimi i marrëveshjes për koncesion.	Zona e mbrojtjes së rreptë
			Ndërtimi i makinerisë në Vratnicka	Zona e menaxhimit aktiv		Zona e menaxhimit aktiv
4.	367	67 Ljubotenska (në lumin Vratnicka)	67 Ndërtimi në Lubotenska 1	Zona e menaxhimit aktiv	Nuk do të vendoset asnjë rrip mbrojtjes, propozohet anulimi i marrëveshjes për koncesion	Zona e mbrojtjes së rreptë
			67 Ndërtimi në Lubotenska 2	Zona e menaxhimit aktiv		Zona e mbrojtjes së rreptë
			Ndërtimi i makinerisë në	Zona për shfrytëzim të qëndrueshëm		Zona e mbrojtjes së rreptë



			Luboten		
--	--	--	---------	--	--